

**Free Co sh. p. k.**

**Pasqyrat Financiare Individuale  
për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019**



Emërtimi dhe forma ligjore: **FREE CO SH.P.K.**  
NUIS: **I.92015001P**  
Adresa e selisë: **RR "Abdi Toptani", Ndërtesa Torre Drim, Kat 4, Ap. 10, Tiranë**  
Data e krijeimit: **15.08.2019**  
Veprimtaria kryesore: Aktivitet i financimit, zotërim i interesave dhe pjesëmarrjeve në shoqëri e sipërmarrje, administrim, kërkim dhe inovim, këshillim dhe asistencë në sektorin e energjisë në përgjithësi.

## **PASQYRAT FINANCIARE INDIVIDUALE PËR PERIUDHËN E MBYLLYR MË 31 DHJETOR 2019**

( Në zbatim të Standardit Kombëtar te Kontabilitetit Nr.15 dhe  
Liqjet Nr. 25/2018 datë 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" )

Pasqyrat Financiare janë individualë:	Po
Pasqyrat Financiare janë të konsoliduara:	Jo
Pasqyrat Financiare janë të shprehura në:	Lekë
Pasqyrat Financiare janë të rrumbullakosura në:	Lekë
Periudha kontabël c Pasqyrave Financiare:	Nga 15.08.2019 deri më 31.12.2019
Data e mbylljes së Pasqyrave Financiare:	29.03.2020

## Përbajtja:

	Faqe
Pasqyra e pozicionit finansiar më 31 dhjetor 2019	3
Pasqyra e performancës dhc të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019	4
Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019	5
Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019	6
Shënimë shpjeguese të pasqyrave financiare	7 - 15



# FREE CO sh. p. k.

Pasqyra e pozicionit finansiar  
për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek)

	Shënimet	<u>31 dhjetor 2019</u>
<b>Aktivet</b>		
<b>Aktivet afatshkurtra</b>		
Mjete monetare	4	61,853,470
Të drejta të arkëtueshme		-
Inventar	5	57,283
Shpenzime të shtyra		-
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<u>61,910,753</u>
<b>Aktivet afatgjata</b>		
Të arkëtueshme nga shoqëritë e kontrolluara	6	148,830,940
Investime në shoqëri të kontrolluara	7	393,855,464
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<u>542,686,404</u>
<b>Totali i aktiveve</b>		<u>604,597,157</u>
<b>Detyrime dhë kapitali</b>		
<b>Detyrime afatshkurtra</b>		
Detyrime afatshkurtra	8	66,361,556
Të ardhura të shtyra		-
Provizione		-
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<u>66,361,556</u>
<b>Detyrime afatgjata</b>		
Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	9	243,540,000
Detyrime afatgjata	10	303,200,583
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<u>546,740,583</u>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<u>613,102,139</u>
<b>Kapitali dhe rezervat</b>		
Kapitali i nënshkruar	1	1,220,000
Fitimi (humbja) i pashpërndarë		-
Fitimi (humbja) e viti		<u>(9,724,982)</u>
<b>Totali i kapitalit</b>		<u>(8,504,982)</u>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<u>604,597,157</u>

Pasqyra e pozicionit finansiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 – 15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019 u aprovuan nga Bordi Drejtues i Free Co sh.p.k, dhe u nënshkruan si më poshtë më 29 mars 2020.

*Ledia Beçi*  
  
**FREE CO**  
 NIS: L 92015001 P  
 Tiranë, Albania

Ledia Beçi  
Administratore

*Janisa*  
  
**HM&H BUSINESS Sh.p.k**  
 NIS: L 31615002K  
 Rr. Abdulla Toptani, Nd. Torre Drin, Kati 4  
 Tiranë, Shqipëri

Janisa  
Kontabël i Miratuar  
HM&H Business Sh.p.k,

# FREE CO sh. p. k.

Pasqyra e performancës dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse  
për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek)

	Periudha e mbyllur Shënimë më 31 dhjetor 2019
<b>Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit:</b>	
Të ardhurat nga shitja	-
Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	-
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	-
<b>Totali i të ardhurave nga aktiviteti i shfrytëzimit</b>	-
<b>Shpenzimet:</b>	
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	-
Shpenzime të personelit:	11
<i>Paga dhe shpërblime</i>	(191,968)
<i>Shpenzime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore</i>	(32,059)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	-
Amortizimi dhe shpenzime konsumi	-
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	12
<b>Totali i shpenzimeve</b>	<u>(10,191,679)</u>
<b>Të ardhura të tjera</b>	-
Zhvlerësimi i aktiveve dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra	-
<b>Të ardhurat dhe shpenzime financiare:</b>	
Të ardhura (shpenzime) nga interesat dhe të ngjashme, neto	-
Të ardhura (shpenzime) nga kursi i këmbimit, neto	13
<b>Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare</b>	<u>690,724</u>
<b>Pjesa e fitimit (humbjes) nga pjesëmarrjet</b>	-
Fitimi (humbja) para tatimit	(9,724,982)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	14
<b>Fitimi (humbja) e vitit</b>	<u>(9,724,982)</u>
<b>Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>	
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:</b>	
Diferencat nga përkthimi i monedhës në veprimtarë të huaja	-
Diferencat nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	-
Diferencat nga rivlerësimi i aktivet financiare të mbajtura për shitje	-
Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet	-
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<u>(9,724,982)</u>

Pasqyra e performancës dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 - 15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

## FREE CO sh. p. k.

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto  
për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat në Lek)

	Kapitali i nënshtuar	Fitimet (humjet) e pasqyrndara	Totali
<b>Pozicioni më 15 gusht 2019</b>	-	-	-
Të ardhura (humje) gjithëpërfshirese për vitin:			
Fitimi (humja) e vitit	-	(9,724,982)	(9,724,982)
Të ardhura (humje) i c'jera gjithëpërfshirese për vitin	-	-	-
Të ardhura (humje) totale gjithëpërfshirese për vitin	-	(9,724,982)	(9,724,982)
Transakzionet me pronarët e njësisë ekonomike të ujohura direkt në kapital:			
Emetimi i kapitalit të nënshtuar	1,220,000	-	1,220,000
Dividendif të paguar	-	-	-
<b>Totali i transakzioneve me pronarët e njësisë ekonomike</b>	<b>1,220,000</b>		<b>1,220,000</b>
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2019</b>	<b>1,220,000</b>	<b>(9,724,982)</b>	<b>(8,504,982)</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 – 15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

# FREE CO sh. p. k.

**Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare**  
për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek)

	Shënimi	Periudha e mbyllur më 31 dhjetor 2019
<b>Fluksi monetar nga (përdorur në) veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		
Pitimi (humbja) e vitit		(9,724,982)
Rregullime për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare		(704,206)
Rimarrje (krijim) i provizioneve		-
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie (Rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		-
Rritje/zvogëlim në tpcicën e inventarit		(57,283)
Rritje (rënje) në detyrimet e pagueshme		66,657,655
Rritje (rënje) në detyrimet për punonjësit		-
<b>Mjete monetare neto nga (përdorur në) veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>56,171,185</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga (përdorur në) aktivitetin e investimit</b>		
Pagesa për blerjen e investimeve financiare asnjegjata		(393,855,464)
Pagesa për financime dhënë filialeve		(149,075,344)
<b>Mjete monetare neto nga (përdorur në) veprimtaritë e investimit</b>		<b>(542,930,808)</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga (përdorur në) aktivitetin e financimit</b>		
Arkëtime nga emetimi i kapitalit		1,220,000
Hua të arkëtuara		244,920,000
Financime nga ortakët		305,321,398
<b>Mjete monetare neto nga (përdorur në) veprimtaritë e financimit</b>		<b>551,461,398</b>
<b>Rritje (rënje) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë mjeteve monetare</b>		<b>64,701,775</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë mjeteve monetare më 15 gusht</b>		-
Efekti i luhajeve të kurseve të këndiminj të mjeteve monetare		(2,848,305)
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë mjeteve monetare më 31 dhjetor</b>	4	<b>61,853,470</b>

Pasqyra e fluksave monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në fajet 7–15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

# FREE CO sh. p. k.

## Shënimë shpjeguese të pasqyrave financiare

për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 1. Informacion i përgjithshëm

Free Co sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shqipëria") është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, krijuar më 31 korrik 2019 dhe regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më 13 gusht 2019 nën numrin unik të identifikimit (NUIS) L92015001P.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë konsiston finansimin, zotërimin e interesave dhe pjesëmarrjeve në shoqëri e sipërmarrje, administrimin, kërkimin dhe inovimin, këshillimin dhe asistencën në sektorin e energjisë në përgjithësi.

Kapitali i nënshtkuar i paguar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2019 është 1,220,000 Lek.

Struktura e ortakëve të Shoqërisë si dbe gjendja e kapitalit më 31 dhjetor 2019 janë si më poshtë:

31 dhjetor 2019		
Ortaku	Vlera në Lekë	%
LO S.r.l.	610,000.00	50.00%
PAPA S.r.l.	610,000.00	50.00%
Totali	1,220,000.00	100.00%

	Kapitali i nënshtkuar	Kapitali i nënshtkuar i papaguar	Totali i kapitalit të nënshtkuar të paguar
Kapitali i nënshtkuar më 13 gusht 2019	1,220,000	-	1,220,000
Emitim i kapitalit	-	-	-
Kapitali i nënshtkuar më 31 dhjetor 2019	1,220,000	-	1,220,000

Përfaqësues ligjore e Shoqërisë është Znj. Ledia Beçi e cila është dhe administratore e emëruar e Shoqërisë.

Selia e Shoqërisë është në Rrugën Abdhi Toptani, Ndërtesa Torre Drin, Kati 4, Ap. 10, Tiranë.

Numri mesatar i punonjësve të Shoqërisë gjatë vitit 2019 është 1.

### 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

#### 2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale bazuar në Standardet Kombëtare të Konfidencialitetit, të përmirësuara (SKK), të cilat janë të aplikueshmë të mënyre prospektive duke filluar nga data 1 janar 2015.

#### 2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike. Bazat e matjes përfshijnë aktiv, detyrim, të ardhur dhe shpenzim janë përshtkuar në detaje në shënimet shpjeguesc në vijim.

#### 2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhë monedha funksionale e Shoqërisë.

#### 2.4 Vlerësimi dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushqyrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël nijohen në periudhën më të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe më perlidhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshtkuar në shënimet përkatese të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është mënyrë më kompjutatorisht e realizuar nga Shoqëria.

# FREE CO sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat të paraqitura në pasqyrat financiare.

#### 3.1 Transaksionet dhe balanceat në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale duke regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedha të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Zërat jemonetare është cilat përllogariten me kostot historike të monedhë të huaj, konvertohen duke përdorur kurset e këmbimit të datave të transaksionit filletar. Zërat jemonetare të cilat njihen me vlerën e drejtë, në monedhë të huaj, konvertohen duke përdorur kurset e këmbimit në datën kur përcaktohet vlera e drejtë. Humbja ose fitimi që rezulton nga konvertimi i zërave jemonetare trajtohet në të njëjtën mënyrë si njohja e humbjes ose fitimit nga ndryshimi i vlerës së drejtë të zërave të pasqyrës së pozicionit finanziar (p.sh. diferenca e konvertimit në zëra të cilave u njihet humbja ose fitimi në pasqyrën e performancës).

31 Dhjetor 2019

1 EUR

121.77

#### 3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiare jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marrta dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme. Një instrument finansiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Instrumentat financiare jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus qdo kostot transaksiom që lidhet me to, përvç siç përshtruhet më poshtë. Për instrumentet e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimi/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentet financiare jo-derivativë maten siç përshtruhet më poshtë.

Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit finanziar ose kur shoqëria transferon aktivin finanziar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare njihen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të bllojë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

##### Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare duc ekuivalentet e tyre përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me bankat si dhe investime të tjera afatshkurtra shumë liknide me maturim original tre ose më pak muaj, të cilat janë objekt reziku jo domelliçnës ndaj ndryshimeve në vlerë dhe që përdoren nga Shoqëria në menaxhimin e detyrimeve të së sain afatshkurtra.

##### Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kostot të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizoni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështrimisht financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentoje ose riorganizimi i tij finansiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizonit llogaritet si diferenca midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skonjuara me normën efektive të interesit.

##### Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kostot të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

7/4

# FREE CO sh. p. k.

Shënim shpjeguese të pasqyrave financiare  
për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

## Hua të marra dhe të dhëna

Huajt e marrë dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e drejtë, pa përfshirë koston e transaksioneve.

## Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjetave monetare dhe ekuivalenteve të tyre, të kërkuesave për tu arkëtuar, detyrimeve për tu paguar dhe huave përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

## Të tjera

Instrumenta të tjera jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

## Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

### 3.3 Aktive afatgjata materiale

#### (i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktive afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen me blerjen e aktivitës si dhe kosto të tjera direkte që lidhen me sjelljen e aktivitës në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij. Kostoja e aktiveve të veftë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, që kosto tjetër të lidhur drejt-përdrejt me sjelljen e aktivitës në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitës. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitës kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohen amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në koston e aktivitës nuk përfshihen kostot e huamarijes të cilat njihen si shpenzime në momentin kur ato ndodhin.

Në rastet kur pjesë të një aktivitës afatgjatë materiali kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrijet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shiljes me vlerën e mbetur, duke këto përfshihen në të ardhura të tjera në pasqyrën e performancës.

#### (ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shugëria do të realizojë përshtime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese duke kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

#### (iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve illogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit, nabi jetën e dobishme të vlerësuar të çdo pjesë të aktivitës afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marrë me qira amortizohen duke marrë përfundimisht të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitës. Toka nuk amortizohet.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

### 3.4 Zhvlerësimi

#### (i) Aktivet financiare

Një aktiv finanziar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ujgjaje kanë efekte negaive në flukset e ardhshme që parashikohet të burejnë nga aktivitë.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin finansiar, të matur me kosto të amortizuar, illogaritet si diferenca midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukteve të ardhshme të parashikuara të parashikuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme individualisht testohen përfundimisht në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kauç karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

# FREE CO sh. p. k.

## Shënimë shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shijë i njohur më parë nc kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi ruanet nëse rimarja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarja njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

### (ii) Aktivet jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përeaktnar njëc ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Iumbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

### 3.5 Provizionet

Një provizion njihet njëc, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse daëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përeaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vletën në kohë të parasë dhe për reziqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

### 3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

### 3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesë nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesë njihen mbi bazën e të drejtave që detyrimet te konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesë mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogaritë fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me mëndën e interesit efektiv.

### 3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tafault mbi fitimin përfshin tatimin aktual të periudhës si dhe tatimin e shtyre. Tatimi aktual dbe tatimi i shtyre njihen drejtpërdrejt në pasqyrën e performancës përvç rasteve kur këto lidhen me zëra që njihen direkti në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Kompensimi midis aktiveve tatimore aktuale dhe detyrimet tatimore aktuale ose midis aktiveve tatimore të shtyra dbe detyrimet tatimore të shtyra kryhet vetëm nëse ekziston një e drejtë ligjore për të kompensuar këto shuma ose kur do të paguhet shuma neto e tyre apo do të realizohen aktivet dhe do të shlyhen detyrimet në të njëjtën kohë.

#### Tatimi aktual

Tatimi aktual është përllogaritje e tatimit mbi fitimin të pageshëm në lidhje me fitimin e tatushëm të periudhës kontabël aktuale duke përdorur normën e tatimit në fuqi të datën e raportimit si dhe sistemimet në lidhje me tatimin e pageshëm për periudha të shkuara.

Aktivet dhe pasivet tatimore përllogariten në vlerën e pritshme që do të kompensohet ose do t'u paguhet autoritetevet tatimore. Për llogaritjen e vlerave u bëhet referencë normës tatimore dhe legjislacionit tatimor në fuqi në Republikën e Shqipërisë në datën e raportimit. Fitimi i tatushëm i periudhës ndryshon nga fitimi neto i paraqitur në pasqyrën e performancës si pasojë e rregullimeve në zërat e ardhurave ose shpenzimeve të cilat janë tatuuar apo njohur si të zbritshme në periudha të tjera si dhe zërave të cilët nuk janë të tatushëm apo të zbritshëm bazuar në legjislacionin tatimor në fuqi.

Drejtimi i shoqërisë në mënyrë periodike vlerëson qëndrimet e mbajtura në përgatitjen e deklaratave tatimore për ato raste në të cilat parashikimet e legjislacionit tatimor në fuqi janë subjekt i interpretimit nga ana e organeve tatuimore shqiptare dbe krijon provizione aty ku është e përshtatshme.

# FREE CO sh. p. k.

## Shënimë shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### Tatimi i shtyrrë

Tatimi i shtyrrë njihet si pasojë e diferencave të përkohshme midis vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Një aktiv tatimor i shtyrrë njihet për të gjitha diferencait e përkohshme të zbritshme, humbjet tatimore dhe kreditimet tatimore të papërdorura, për aq sa ato ka mundësi të mbulohen nga përfitimet e ardhshme tatimore. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri në masën që ka mundësi që të realizohet përfitimi tatimor. Aktivet tatimore të shtyra të panjohura rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen deri në atë vlerë që do të jetë e mundur për të mbuluar aktivet tatimore të shtyra me filimin e tatushëm të viteve të ardhshme.

Aktivi apo detyrimi tatimor i shtyrrë nuk njihet për diferencait e përkohshme të lidhura me:

- njojjen e emrit të mirë;
- filmet e papaguara nga investimet në filialat e huaja, degët, pjesëmarrjet dhe sipërmarrjet e përbashikëta në masën që investimi është i përhershëm i në kohëzgjatje përvçese kur është e dukshme që e dukshme që diferencait e përkohshme do të rimerren në të ardhmen e parashikueshme.

Aktivet dhe detyrimet tatimore të shtyra përllogariten sipas normës tatimore në fuqi në datën e raportimit.

### 4. Mjetet monetare

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2019 janë përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2019
Arka në Lek	4,075
Llogari rrjedhëse:	
Në Lek	18,690
Në Euro	61,830,705
<b>TOTALI</b>	<b>61,853,470</b>

### 5. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2019 konsiston në malha të blera me qëllim rishijen tek palë të treta dhe lëvizjet gjatë periudhës paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019
Gjendja e inventarit të imët në fillim të periudhës	-
Blerje gjatë periudhës	57,283
<b>Gjendja e inventarit të imët në fund të periudhës</b>	<b>57,283</b>

### 6. Të arkëtueshme nga shoqëritë e kontrolluara

Të arkëtueshmet nga shoqëritë e kontrolluara më 31 dhjetor 2019 në vlerën 148,830,940 Lek konsistojnë në financime dhënë shoqërisë së kontrolluar Kisi-Bio-Energji sh.p.k.. Vlera e financimeve në monedhën origjinale më 31 dhjetor 2019 është e përbërë nga financimi prej 25,426.76 Lek dhe nga financimi në monedhën euro prej 1,222,021.13 Euro. Vlera e të arkëtueshmeve në monedhën Euro më 31 dhjetor 2019 është rivlerësuar me kursin e këmbimit publikuar nga Banka e Shqipërisë prej 121.77 Lek/Euro.

### 7. Investime në shoqëri të kontrolluara

Investimet në shoqëri të kontrolluara përfshijnë koston e investimit në shoqërinë Kisi-Bio-Energji sh.p.k.. Vlera e investimeve në shoqëri të kontrolluara më 31 dhjetor 2019 është 393,855,464 Lek.

# FREE CO sh. p. k.

Shënimë shpëreguese të pasqyrave financiare  
për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

## 8. Detyrime afatshkurtra

Detyrimet afatshkurtra më 31 dhjetor 2019 janë përbërë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	3,944,519
Të pagueshme ndaj punonjësve	36,519
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore dhe TAP	13,707
TVSH për tu paguar	735,840
Tatim i mbajtur në burim	745,970
Detyrime doganore	
Detyrime për blerjen e aktiveve financiare afatgjata	60,885,000
<b>TOTALI</b>	<b><u>66,361,556</u></b>

## 9. Detyrime ndaj institucioneve të kredisë

Detyrime ndaj institucioneve të kredisë më 31 dhjetor 2019 në vlerën 243,540,000 Lek konsiston në huaz bankare marrë pranë Intesa SanPaolo Bank. Disbursimi i huasë është kryer në vitin 2019, por shtyerja e saj fillon në vitin 2020. Vlera e huasë në monedhë origjinale është 2 milion Euro, konvertuar me kursin e publikuar nga Banka së Shqipërisë në datën e pasqyrave financiare prej 121.77 Lek/Euro.

## 10. Detyrime afatgjata

Detyrimet afatgjata më 31 dhjetor 2019 në vlerën 303,200,583 Lek konsistojnë uç paradhënie nga ortakët për financimin e veprimitarive operacionale dhe investuese të Shoqërisë. Vlera e detyrimeve në monedhën origjinale më 31 dhjetor 2019 është 2,489,944.84 Euro.

## 11. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019 përbohen uga pagat dhe kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si më poshtë:

	<u>Periudha e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Paga dhe shpërblime	191,968
Shpenzime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	32,059
<b>TOTALI</b>	<b><u>224,027</u></b>

## 12. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019 përbohen si më poshtë:

	<u>Periudha e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime zyre	63,725
Shpenzime kaneclarie	3,500
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	200
Shpenzime përkthimi	217,000
Shërbim adresë selje	66,121
Shërbime notariale	592,212
Shërbime komabël dhe fiskale	1,564,637
Shërbime ligjore	1,857,269
Konsulencë teknike	5,413,420
Komisionet dhe shërbimet bankare	371,511
Taksa dhe tarifa vendore	42,084
<b>TOTALI</b>	<b><u>10,191,679</u></b>

# FREE CO sh. p. k.

## Shënimë shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 13. Të ardhura (shpenzime) nga kursi i këmbimit, neto

Të ardhurat (shpenzimet) nga kursi i këmbimit, neto për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019 përbëhen si më poshtë:

	Periudha e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Pitime të realizuara nga kursi i këmbimit	8,039
Pitime të parcalizuara nga kursi i këmbimit	<u>3,863,051</u>
	<b><u>3,871,091</u></b>
Ilumbje të realizuara nga kursi i këmbimit	(21,521)
Ilumbje të parcalizuara nga kursi i këmbimit	<u>(3,158,846)</u>
	<b><u>(3,180,367)</u></b>
<b>TOTALI</b>	<b><u>690,724</u></b>

### 14. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Bazuar në legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 5% për tatimpaguesit me qarkullim vjetor deri në 14 milionë Lek dhe 15% për tatimpaguesit me qarkullim vjetor mbi këtë shumë.

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dbe shpenzimet e deklaruarë për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dbe regjistrimet e tatimpaguesit dho lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

#### (i) Shpenzimi i tatimit mbi fitimin aktual

Për vitin 2019 Shqipëria ka rezultuar me humbje kontabël dbe tatimore. Ilumbja fiskale e vitit 2019 paraqitet në tabelat e mëposhtme:

	2019
Të ardhura	3,871,091
Shpenzimet	<u>(13,596,073)</u>
<b>Rezultati kontabël</b>	<b><u>(9,724,982)</u></b>

#### Rregullime për diferenca të përkohshme:

Shpenzime të përllogaritura	-
<b>Fitimi/(humbja) pas rregullimeve</b>	<b><u>(9,724,982)</u></b>

#### Shpenzime të panjohura:

Shërbime konsulencë fiskale	1,388,363
Shërbime ligjore	1,857,269
Shpenzime postare dbe telekomunikimi	200
Shërbime notariale	592,212
Konsulencë teknike	5,413,420
Shpenzime përkthimi	217,000
Shpenzime zyre	61,025
<b>Totali i shpenzimeve të panjohura</b>	<b><u>9,529,489</u></b>

#### Fitimi /(humbja) tatimore për periudhën

Humbje tatimore të mbartura	-
Eshirje e humbjeve tatimore pa të drejtë mbartje	-
<b>Fitimi/(humbja) tatimore kumulative</b>	<b><u>(195,493)</u></b>

Bazuar në legjislacionin tatimore shqiptar, Shqipëria ka të drejtë të mbartë humbjet tatimore për një periudhë tre vjeçare. Në rast se gjatë një periudhe pronësia e drejtperdrejtë apo e tertiortë e kapitalit të shqëritë apo të drejtave të votës ndryshon me më shumë se 50%, atëherë e drejta e mbartjes së humbjeve të realizuara nga shqipëria në periudhën tatimore kur ndodh ndryshimi, si dhe në periudhat paraardhëse, nuk zbatohet.

Balanca e humbjeve tatimore për t'u mbartur në periudhat vijuese është 195,493 Lekë.

# FREE CO sh. p. k.

Shënim shpjeguese të pasqyrave financiare  
për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

## Rikonecimi i normës efektive të tatimit:

	2019	%
Fitimi/(Humbja) e periudhës para tatimit	(9,724,982)	100%
Fitimi/(Humbja) tatimore me shkallën tatimore standarde	(486,249)	5.00%
<i>Rregullime për:</i>		
Të ardhura të patatueshme	-	0.00%
<i>Shpenzime të panjohura:</i>		
Shërbime konsulencë fiskale	69,418	-0.71%
Shërbime ligjore	92,863	-0.95%
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	10	0.00%
Shërbime notariale	29,611	-0.30%
Konsulencë teknike	270,671	-2.78%
Shpenzime përkthimi	10,850	-0.11%
Shpenzime zyre	3,051	-0.03%
<b>TOTALI</b>	<b>(9,775)</b>	<b>0.10%</b>

## (ii) E ardhura (shpenzimi) për tatimin e shtyrë

Tabelat në vijim paraqesin illogaritjet në lidhje me tatimin e shtyrë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019. Shoqëria ka zgjedhur të mos vjohë aktívini tatimor të shtyrë pasi disponueshmëria e fillojne të tatuueshme përvitet vjuese nuk është e sigurtë.

	Humbje tatimore të mbartura	Totali
<b>Aktivi tatimor i shtyrë</b>		
<b>Më 15 Gusht 2019</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
E ardhura (shpenzimi) nga tatimi i shtyrë mbi fitimin	9,775	9,775
<b>Më 31 Dhjetor 2019</b>	<b>9,775</b>	<b>9,775</b>

I.ëvzjet në logarinë e tatimit të shtyrë paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2019</b>
<b>Në fillim të periudhës</b>	<b>-</b>
E ardhura (shpenzimi) nga tatimi i shtyrë mbi fitimin	9,775
<b>Në fund të periudhës</b>	<b>9,775</b>
Tatimi i shtyrë i panjohur	(9,775)
<b>Balanca e mbylljes</b>	<b>-</b>

## 15. Transaksionet me palët e lldhura

Në datën e bilancit, shumat e mëposhtme u korrespondojnë ortakëve të Shoqërisë si dhe shoqërive të kontrolluara:

	<b>31 dhjetor 2019</b>
<b>Të arkëtueshme nga palë e lldhura:</b>	
Paradhënie për Kisi-Bio-Energji sh.p.k.	148,830,940
<b>Defyritme ndaj palëve të lldhura:</b>	
Paradhënie nga ortakët për shpenzinë operacionale	-
Parapagime nga ortakët	303,200,583
<b>Valioni i transakstoner me palët e lldhura</b>	
Arkëtine për financime dhënë filialeve	-
Pagesa për financime dhënë filialeve	(149,075,344)
Arkëtine nga financimet e ortakëve	305,321,398

## 16. Angazhimi duc pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lldhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin finansiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.



# FREE CO sh. p. k.

Shënimë shpjeguese të pasqyrave financiare  
për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

## 17. Ngjarje të mëpasshme

Nuk ka asnjë ngjarje të mëpasshme pas datës së raportimit e cila kërkon irregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

